

**RENDI I DITËS**

**Projektvendimi “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.**

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

• **Komisioni Rregullator:**

- **Ilirjana NANO Kryetar**
- **Arens ÇELA Anëtar (on-line)**
- **Dritan ÇAKA Anëtar**
- **Helga VUKAJ Anëtar (nuk është prezent)**
- **Muharrem ÇAKAJ Anëtar (on-line)**
- **Stafi KQZ Y. Merkaj**

**Parti Politike: S’ka prezent**

**OJQ: KRIIK**

**Znj. I. Nano:** Mirëdita fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator të njoftuar për ditën e sotme. Në mbledhje janë prezent, në sallë dy anëtarë të Komisionit Rregullator, on-line janë zoti Muharrem Çakaj dhe zoti Arens Çela. Ju lutem më konfirmoni, në se janë kolegët në linjë?!

**Z. M. Çaka:** Po, prezent!

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.07.08.2023*

**Znj. I. Nano:** Zoti Çela?! Edhe zoti Çela është në linjë. Mungon zonja Vukaj. Pra, e zhvillojmë mbledhjen me praninë e katër anëtarëve të Komisionit Rregullator. Në rendin e ditës së mbledhjes së sotme kemi projektvendimin: “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”. Është akti i fundit i këtij procesi zgjedhor. Pasi janë zhvilluar zgjedhjet e përsëritura dhe në një zonë, kanë përfunduar ankimet qoftë në KAS, apo dhe në Kolegjin Zgjedhor. Janë shpërndarë mandatet nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, pasi kanë kaluar dhe afatet e ankimimit ndaj vendimit më të fundit të Komisionerit, mbledhemi sot për të shpallur rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve. Duke qenë se është një akt i propozuar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, do të doja që Sekretari i Përgjithshëm, në mënyrë të përmbledhur të na fliste për përmbajtjen e aktit dhe relacionin përkatës. Zoti Merkaj!

**Z. Y. Merkaj:** Faleminderit! Referuar nenit 20 të Kodit Zgjedhor, Komisioni Rregullator shqyrton dhe miraton projektaktet me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e KQZ-së për rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në shkallë vendi në përputhje me këtë ligj. Në mbështetje të Dekretit të Presidentit më datën 14 maj 2023 u zhvilluan Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore. Në përfundim të shqyrtimeve administrative në KQZ, disa prej vendimeve të KQZ-së u ankimuan në KAS e më pas në Kolegjin Zgjedhor. Koalicioni “Bashkë Fitojmë” dhe kandidati për kryetar bashkie, Bashkia Rrogozhinë, paraqitën pranë Kolegjit Zgjedhor, padi për ndryshimin e vendimit nr.174 dt.06.06.2023 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, i cili miratoi tabelës e re përmbledhëse të rezultatit për kandidatët për kryetarin e Bashkisë Rrogozhinë. Në përfundim të shqyrtimit administrativ, Kolegji Zgjedhor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë vendosi pavlefshmërinë e zgjedhjeve vendore të datës 14 maj 2023 në Zonën e Administrimit Zgjedhor nr. 43 për kryetar të Bashkisë Rrogozhinë, duke urdhëruar përsëritjen e këtyre zgjedhjeve.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*






*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.07.08.2023*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në zbatim të urdhërimeve të Kolegjit Zgjedhor në datën 04.07.2023 me vendim, caktoi datën 23 korrik 2023 për zhvillimin e zgjedhjeve të përsëritura për kryetarin e Bashkisë Rrogozhinë. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbështetje të nenit 162, 163 dhe 166 të Kodit Zgjedhor, përlllogariti shpërndarjen e mandateve për çdo zonë zgjedhore, mbi bazën e numrit të votave të vlefshme si dhe kandidatët fitues për kryetarët e bashkive dhe këshillat bashkiakë për çdo zonë zgjedhore. Komisioni Rregullator, pas shpalljes së rezultatit për shpërndarjen e mandateve për çdo zonë zgjedhore nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbështetje të nenit 20, pika 2, shkronja “d” dhe nenit 167 të Kodit Zgjedhor, Komisioni Rregullator shpall me vendim rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve. Në bazë të nenit 2, pika 18, germa “b” dhe “c” të Kodit Zgjedhor rezultati përfundimtar i zgjedhjeve i shpallur nga KQZ përmban:

1. Rezultatin e votimit për kandidatët për kryetar bashkie të cilët janë zgjedhur në mënyrë të drejtëpërdrejtë në zonën zgjedhore përkatëse;
2. Numrin e votave të fituara nga secili subjekt në shkallë kombëtare, bazuar në rezultatin e votave të fituara nga çdo subjekt zgjedhor në votimin për këshillat e qeverisjes vendore.

Për sa më lart në këtë relacion, administrata e KQZ-së nëpërmjet Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në Kodin Zgjedhor, i propozon për shqyrtim dhe miratim Komisionit Rregullator, projektvendimin “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, si dhe tabelat përmbledhëse për mandatet për çdo kryetar bashkie fitues si dhe numërin e votave të fituara për çdo subjekt zgjedhor.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.07.08.2023*


**Znj. I. Nano:** Faleminderit zoti Merkaj, fillojmë shqyrtimin e projektvendimit. Së pari çelim diskutimin në parim, kolegë ka diçka në parim lidhur me këtë projektvendim? Po, zoti Çakaj!

**Z. M. Çakaj:** Atëherë, pavarësisht se në bazë të rregullores tonë, nuk është momenti i procesit të votimit, unë do të doja.., së pari ju bëj me dije që vota ime në parim, është kundër miratimit të këtij projektakti. Për të mos ju marrë dhe juve kohë në diskutimet nen për nen, do të doja t’ju bëja me dije arësyet se pse vota ime është kundër miratimit në parim dhe më pas dhe të miratimit në tërësi të këtij projektakti. Siç e dimë të gjithë palët në nenin 45 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, parashikohet se “vota është vetjake, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë”. Për rrjedhojë dhe procesi që garanton votën, pra procesi zgjedhor duhet të plotësojë të njëjtat standarde. Pra, pyetja që shtrohet për të gjithë shqiptarët sigurisht që dhe për ne si anëtarë të Komisionit Rregullator është kjo: A ishin këto zgjedhje të barabarta? A ishin këto zgjedhje të lira? A ishin këto zgjedhje të fshehta? Unë personalisht mendoj që jo dhe mendimin tim se pse këto zgjedhje nuk ishin të barabarta, të lira dhe të fshehta e kam për këto arsye:

Së pari, këto zgjedhje nuk ishin të barabarta, pasi njëra nga palët, jo vetëm që përdori të gjithë makinerinë dhe resurset e pushtetit, por ndikoi qoftë në KQZ nëpërmjet vendimmarrjeve të saj. Qoftë në sistemin gjyqësor për përcaktimin e palës kundërshtare e cila do të merrte pjesë në zgjedhje. Pra, identifikoi si të thuash, ose u mundua dhe e arriti të ndikojë në të gjithë sistemin, të përcaktojë palën kundërshtare. Në këtë mënyrë, pala e cila sot ka pushtetin ekzekutiv, përcaktoi kundërshtarin duke mos lejuar, në gjykimin tim personal, garimin e opozitës reale në këto zgjedhje.

Së dyti, këto zgjedhje nuk ishin të lira pasi gjysma e zgjedhësve shqiptarë, pa ndonjë shkak të përligjur, nuk kishin në fletën e votimit, një alternativë të cilën ata do të

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.07.08.2023*

donin ta votonin. Ky fakt ndikon drejtë për drejtë në lirinë e tyre për të zgjedhur. Pra, cënon drejtpërdrejtë në të drejtën e tyre kushtetuese.

Së treti, këto zgjedhje nuk ishin të barabarta, pasi pala së cilës ju hoq mundësia për të qenë në fletën e votimit, rrjedhimisht mundësia e drejtpërdrejtë për t'u zgjedhur, nuk pati dhe nuk përfitoi, siç parashikon Kodi Zgjedhor, asnjë resurs ligjor për fushatë. Si: mjet financiar, kohë televizive, komisionerë, etj..

Këto zgjedhje nuk ishin të lira, të barabarta, apo të drejta, pasi qeveria miratoi ligje dhe akte nënligjore për rritje pagash, shpërblime pensioni në kundërshtim të plotë me Kodin Zgjedhor dhe praktikën e Komisionit të Venecias, me qëllim përfitimin e padrejtë të votave. Siç ju jeni në dijeni, ne kemi dëgjuar se kandidatati për kryetar të Bashkisë Himarë, ndodhet në burg për dyshime se ka blerë vota. Në fakt çfarë ndryshimi ka qeveria që shpërndan lekët e popullit për të rritur pagat dhe pensionet para zgjedhjeve, me qëllimin që të fitojë vota, me një kandidat që akuzohet se blen me lekët e tij votë? Në gjykimin tim më fajtor, sigurisht që të dy palët fajtorë janë, por në gjykimin tim më fajtorë është qeveria në këtë rast, pasi nuk përdor as lekët e saj, përdor lekët e popullit. Gjithashtu vlen të theksohet se në këto zgjedhje, për fat të keq, përsëri pati votim familjar, si dhe ajo që për ne si KQZ duhet të ishte histori suksesi, siç është implementimi i teknologjisë, veçanërisht në procesin e votimit dhe numërimit elektronik. Nuk mund të konsiderohet histori suksesi, pasi rriti dukshëm mosbesimin ndaj palëve. Për të gjitha këto arsye, por dhe shumë e shumë të tjera, për të mos marrë kohën tuaj, unë jam kundër miratimit në parim të këtij projektakti dhe do të ftoja të gjithë kolegët të jepnin në unanimitet dhe me realizëm votën e tyre, faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Faleminderit zoti Çakaj! Kolegët e tjerë kanë diçka në parim për projektaktin? Edhe unë do të shtoja dy fjalë, në fakt duke respektuar kolegët që shprehin mendimin e tyre në mbledhje, unë do të thoja që sot nuk kemi të bëjmë me

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.07.08.2023*

analizën e zgjedhjeve, por me shpalljen e rezultatit i cili tashmë siç u theksua dhe më herët ka kaluar në të gjitha fazat e shqyrtimit, ankimit administrativ dhe atij gjyqësor. Pra, le të themi që shpallja e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve nga ana e Komisionit Rregullator, merr parasysh gjithë këto procese të zhvilluara gjatë këtyre muajve, ndaj quhet dhe shpallje rezultati, ndërkohë që rezultatet më herët janë miratuar në organet përkatësisht KZAZ, KAS, Kolegj Zgjedhor, Komisioner. Ajo ç'ka tjetër do të doja të shtoja, sepse ndoshta edhe për mediat që janë të pranishme këtu, mund të duket një shpallje e vonuar e rezultatit, por janë respektuar të gjitha afatet. Të mos harrojmë që mandati i kryetarit të Bashkisë Rrogzohinë është dhënë vetëm ditën e martë, pas ripërsëritjes së zgjedhjeve. Janë pritur afatet e ankimit që kanë mbaruar ditën e premte dhe sot bëhet shpallja. Pavarësisht se sot i dimë dhe unë nuk di nëse do të duhet të lexojmë dhe emrat e kryetarëve të bashkive, sot i dimë të gjithë. Dua të them se ky vendim që marrim sot është i rëndësishëm, veç të tjerave, pra, detyrimit që kemi nga Kodi Zgjedhor, është i rëndësishëm edhe për dy arsye të tjera:

- E para, është e rëndësishme data e miratimit të tij, për dekretimin nga ana e Presidentit të Republikës të zgjedhjeve të ardhshme për organet e qeverisjes vendore.
- Është gjithashtu i rëndësishëm, pasi pas nxjerrjes së rezultatit përfundimtar në shkallë vendi, do të duhet KQZ-ja dhe përkatësisht Komisioneri, të përcaktojë me vendim vlerën në lekë të një vote të vlefshme. Të mundësohet më tej shpërndarja e fondeve për subjektet zgjedhore që kanë marrë pjesë dhe kanë fituar përqindje të caktuar votash në këto zgjedhje. Nëse kolegu Çakaj dhe Çela nuk kanë gjë tjetër, po kalojmë në votimin në parim të projektvendimit.

***Kush është dakord kolegë?***

***Pro: 3 (znj. I. Nano, z. A. Çaka, z. A. Çela)***

***Kundër: 1 (z. M. Çakaj)***

Miratohet në parim me tre vota pro dhe një kundër!

***Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU***





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.07.08.2023*

Do të doja të theksoja dhe diçka tjetër. Pasi ndoshta jeni mësuar që votimet tona janë katër me një, sepse kështu e kërkon Kodi Zgjedhor. Ky është një ndër projektvendimet që kërkon shumicë të thjeshtë. Pra, ky projektvendim parashikohet në nenin 20, pika 2 ku Rregullatori miraton rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në shkallë vendi dhe ky vendim sipas pikës 3, po të nenit 20 miratohet me shumicë të thjeshtë.

Atëherë kalojmë në votimin nen për nen. Me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator vendosi:

1. Të shpallë rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, si më poshtë:

a) rezultatin e votimit për kandidatët për kryetar bashkie, të cilët janë zgjedhur në mënyrë të drejtpërdrejtë në zonë zgjedhore përkatëse, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.


b) numrin e votave të fituara nga secili subjekt në shkallë kombëtare, bazuar në numrin e votave të fituara nga çdo subjekt zgjedhor në votimin për këshillat e qeverisjes vendore, sipas lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Atëherë, besoj të pranishmit janë njohur me projektvendimin. Lidhja 1, janë kryetarët e bashkisë fitues dhe lidhja 2, janë numri i votave dhe përqindjet që ka marrë secili subjekt. Në varësi të interesit tuaj, dëshironi të lexoj emrat, apo jeni të njohur me këtë? Dëshironi të lexoj përqindjen? Mos ndoshta ka kjo më tepër interes? Kolegë, dhe ju si e vlerësoni? Zoti Merkaj, projektvendimi është shpallur në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve?

**Z. Y. Merkaj:** Po, po!

**Znj. I. Nano:** Nëse për median ka interes të lexoj numrin e votave, përqindjen për subjektet, më thoni!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.07.08.2023*

Atëherë, po lexoj vetëm lidhjen 2, numrin e votave të fituara nga secili subjekt në shkallë kombëtare, bazuar në rezultatin e votave të fituara nga çdo subjekt zgjedhor në votimin për këshillat e qeverisjes vendore:

Partia Socialiste e Shqipërisë, 579.625 vota, ose 43,11%;  
Bashkë Fitojmë, 247.883 vota, ose 18,44%;  
Partia Demokratike, 103.723 vota, ose 7,71%;  
Partia Socialdemokrate, 86.283 vota, ose 6,42%;  
Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë, 44.047 vota, ose 3,28%;  
Partia Republikane Shqiptare, 32.071 vota, ose 2,39%;  
Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet, 28.978 vota, ose 2,16%;  
Partia Levizja e Legalitetit, 23.683 vota, ose 1,76%;  
Aleanca Progresiste LZHK, 22.906 vota, ose 1,70%;  
Partia Demokracia Sociale, 21.798 vota, ose 1,62%;  
Fryma e Re Demokratike, 18.459 vota, ose 1,37%;  
Aleanca Liberale e Djathtë, 16.859 vota, ose 1,25%;  
Partia e Gjelbër, 16.326 vota, ose 1,21%;  
Aleanca Arbnore Kombëtare, 11.680 vota, ose 0,87%;  
Nisma Thurje, 10.804 vota, ose 0,80%;  
Partia Balli Kombëtar, 7.611 vota, ose 0,57%;  
Lëvizja Bashkë, 7.539 vota, ose 0,56%;  
Ardhmëria Shqiptare, 6.963 vota, ose 0,52%;  
Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë, 6.373 vota, ose 0,47%;  
Partia Kristian Demokrate, 6.211 vota, ose 0,46%;  
Partia Aleanca Demokratike e Shqipërisë, 6.131 vota, ose 0,46%;  
Partia Unitetit Kombëtar, 5.593 vota, ose 0,42%;  
Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet, 4.647 vota, ose 0,35%;  
Bindja Demokratike, 4.226 vota, ose 0,31%;

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.07.08.2023*

Partia Konservatore, 2.767 vota, ose 0,21%;

Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen MEGA, 2.275 vota, ose 0,17%;

Partia Kombëtare Konservatore Albania, 1.881 vota, ose 0,14%;

Partia Ora e Shqipërisë, 1.455 vota, ose 0,11%;

Partia e Reformave Demokratike Shqiptare, 1.383 vota, ose 0,1%;

Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane, 1.125 vota, ose 0,08%;

Lëvizja e Re LRE, 966 vota, ose 0,07%;

Partia Komuniste e Shqipërisë, 915 vota, ose 0,07%’

Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve, 886 vota, ose 0,07%;

Partia për Europeanizim dhe Integrimin e Shqipërisë, 801 vota, ose 0,06%;

Partia Mbrojtjen e të Drejtave të Puntorve të Shqipërisë, 671 vota, ose 0,05%;

Lëvizja Punëtore Shqiptare, 546 vota, ose 0,04%;

Aleanca Maqedonasve për Integrimin Europian, 439 vota; ose 0,03%;

Partia Emigracionit Shqiptar, 317 vota, ose 0,02%;

Fronti i Majtë, 270 vota, ose 0,02%;

Lidhja Demokristiane Shqiptare, 216 vota, ose 0,02%;

Më tej vijojnë kandidatët e propozuar nga zgjedhësit të cilët janë zgjedhur si anëtarë të këshillave bashkiakë.

Diogjen Kolic, 1.245 - 0,09%;

Astrit Ademi, 938 - 0,07%;

Festim Kaso, 938 - 0,07%;

Lazjon Petri, 813 - 0,06%;

Rinaldo Piroli, 698 vota 0,05%;

Ibrahim Bajrami, 680 vota 0,05%;

Mitat Daja, 666 vota 0,05%;

Agim Hysa, 588 vota 0,04%;

Fatjon Biba, 308 vota 0,02%;

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.07.08.2023*

Soreldo Nebo, 291 vota 0,02%.

Atëherë, pasi u lexua lidhja përkatëse në pikën “b”, në shkronjën “a”, të pikës 1 të projektvendimit, me konsensusin tuaj nuk i lexova të gjithë emrat, kalojmë në votimin e pikës 1 dhe normalisht votimin e të dy lidhjeve. Kolegë,

***Kush është dakord me këtë pikë?***

***Pro: 3 (znj. I. Nano, z. A. Çaka, z. A. Çela)***

***Kundër: 1 (z. M. Çakaj)***

Miratohet me tre vota pro, një kundër!

Pika 2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

***Kush është dakord?***

***Pro: 3 (znj. I. Nano, z. A. Çaka, z. A. Çela)***

***Kundër: 1 (z. M. Çakaj)***

Miratohet!

Pika 3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

***Kush është dakord?***

***Pro: 3 (znj. I. Nano, z. A. Çaka, z. A. Çela)***

***Kundër: 1 (z. M. Çakaj)***

Miratohet me tre vota pro dhe një kundër!

Kalojmë në votimin në tërësi të projektvendimit. Edhe njëherë kolegë, do t’ju ftoja për të shprehur vullnetin lidhur me miratimin në tërësi të projektvendimit “Për

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.07.08.2023*

shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

*Kush është dakord?*

*Pro: 3 (znj. I. Nano, z. A. Çaka, z. A. Çela)*

*Kundër: 1 (z. M. Çakaj)*

Me tre vota pro dhe një kundër, miratuam shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Duke qenë se nuk kemi çështje tjetër në rendin e ditës për të shqyrtuar, mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

**Vendimi nr. 27**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

